



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br.No. 1317/2018  
Nr.i fqi/Er.str./Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 29/05/18



PRISHTINË-PRIŠTINA-PRISTINA  
Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## RAPORT ME REKOMANDIME

A.nr. 910/2016

Milorad Stojanović

Ilidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë

Për: Znj. Afërdita Bytyçi, Kryetare

Gjykata Themelore në Prishtinë

Prishtinë, më 29 maj 2018.

## **Qëllimi i raportit**

1. Qëllimi i këtij rapporti është që t'i tërhiqet vëmendja Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën A.nr. 2263/2015 pa vonesë të mëtejshme.
2. Ky rapport është bazuar në ankesën individuale të z. Milorad Stojanović (në vazhdim ankuesi) dhe bazohet në faktet dhe dëshmitë ankuesit dhe shkresat e lëndës me të cilat disponon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në lidhje me kohëzgjatjen e procesit gjyqësor në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për konteste administrative.

## **Baza ligjore**

3. Sipas nenit 135. paragrafi 3. të Kushtetutës: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”.
4. Gjithashtu, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16. paragrafi 8, përcakton që: “*Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme përfunksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvëç rastit kur ka zvarritje të procedurave*”.

## **Përbledhje e fakteve**

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat disponon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) mund të përblidhen si në vijim:

5. Në gusht të vitit 2015, ankuesi, në emër të babait të tij, Vojislav Stojanović, i është drejtar Drejtorisë për Gjeodezi, Pronë dhe Kadastër (DGJPK) në komunën e Graçanicës, me kërkesë për ndërrimin e emrit të mesëm në fletën poseduese, certifikata 34-11252 KK Graçanicë, me pretendimin se, në kontratën e shitblerjes V.br.3307/76, datë 27 dhjetor 1976, është shënuar gabimisht emri i babait të blerësit.
6. Më 26 gusht 2015, DGJPK, Komuna e Graçanicës, ka refuzuar të bëjë korrigjimin dhe kërkesa e ankuesit është refuzuar me Aktvendimin nr.678/15.
7. Më 23 shtator 2015, ankuesi ka parashtruar ankesë në Aktvendimin e lartpërmendor tek Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), por më 7 dhjetor 2015, me Aktvendimin nr. 03/2275/15, ankesa është hedhur poshtë si e pabazuar.
8. Më 29 dhjetor 2015, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në Departamentin për konteste administrative, ankuesi ka parashtruar padi për anulimin e Aktvendimit të datës 7 dhjetor 2015, Nr.03/2275/15 DGJPK të Komunës së Graçanicës.
9. Më 15 shkurt 2016, ankuesi, i është drejtar Gjykatës Themelore në Prishtinë me parashtresë për përshtypjen të lëndës., në të cilën është theksuar se paditësi është mbi moshën 80 vjeç dhe në gjendje jo të mirë shëndetësore, por nuk ka pranuar përgjigje.
10. Më 15 dhjetor 2016, ankuesi ka parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit për zvarritje të procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për konteste administrative.

11. Më 7 mars 2017, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të informohet për veprimet e ndërmarra dhe/apo të planifikuara në mënyrë që lënda të zgjidhet në afatin e arsyeshëm kohor. Gjithashtu, në këtë letër është theksuar se lënda nuk është komplekse dhe se bëhet fjalë vetëm për aspektet procedurale të përmirësimit të emrit, si dhe që Gjykata duhet të ketë parasysh faktin që paditësi në këtë lëndë është mbi moshën 80 vjeç.
12. Më 17 mars 2017, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga gjyqtari i lëndës, në të cilën theksohet që më 11 janar 2016, lënda e ankuesit i është dorëzuar gjykatës kompetente për zgjidhje dhe është evidentuar me numër A.nr.2263/2015. Në shkresë është theksuar që lënda ende nuk është në procedurë për zgjidhje për shkak të numrit të madh të lëndëve nga viti 2013 dhe 2014, si dhe që do të procedohet sipas radhës së arritjes në gjykatë dhe sipas natyrës së kontestit.
13. Më 15 qershor 2017, Avokati i Popullit i është drejtuar përsëri me shkresë kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me lëndën e ankuesit.
14. Më 29 shtator dhe 5 dhjetor 2017, si dhe më 2 shkurt 2018, meqë nuk kishte pranuar përgjigje në letrat e dërguara, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresa përkujtuese kryetares së Gjykatës Themelore në Prishtinë, në lidhje me lëndën e ankuesit.,
15. Më datë 7 shkurt 2018, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga gjyqtari i ngarkuar me lëndën e ankuesit, me përbajtje të njëjtë sikurse përgjigjja të cilën e ka pranuar më datë 17 mars 2017. Përgjigja është thirrur në datën e pranimit të lëndës në gjykatë, me të cilin numër është evidentuar, si dhe që gjyqtari i ngarkuar ka numër të madh të lëndëve nga viti 2013, 2014, 2015, 2016 dhe 2017 në të cilat punon dhe se lënda e ankuesit ende nuk është në procedurë për zgjidhje.
16. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, Gjykata Themelore në Prishtinë, departamenti për konteste administrative nuk ka ndërmarrë asnjë veprim procedural në lidhje me lëndën e ankuesit.

#### **Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës**

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, përcakton se: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore [...]*”.
18. E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, përcaktohet me nenin 31.1. të Kushtetutës:  
“*Çdo kujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.*”
19. Po ashtu, mbrojtja gjyqësore e të drejtave, e përcaktuar me nenin 54 të Kushtetutës, parasheh se:  
“*Çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me Kushtetutë ose më ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur*”.
20. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ), sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës është dokument ligjor i

drejtpërdrejtë i zbatueshëm në Republikën e Kosovës dhe ka prioritet në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.<sup>1</sup> Ndërsa, paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së, garanton që:

*“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile, çdo njëri ka të drejtë për një proces të drejtë dhe të hapur brenda një afati të arsyeshëm kohor”.*

21. Ligji për Gjykatat nr. 03/L-199, në nenin 7 paragrafi 2, përcakton se:

*“Çdo person ka qasje të barabartë në gjykata dhe askujt nuk i mohohet e drejta në gjykim të drejtë, në përputhje me procedurën e rregullt ligjore ose të drejtë në mbrojtje të barabartë me ligj. Çdo person fizik apo juridik ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor”.*

22. Ndërsa nen 7, paragrafi 5, Ligjit për Gjykatat, përcakton se:

*“Të gjitha gjykatat duhet të funksionojnë në mënyrë të shpejtë dhe efikase për të siguruar zgjidhjen e shpejtë të lëndëve”.*

### **Analiza ligjore**

23. Ankuesi ka parashtruar ankesë për zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për konteste administrative dhe pretendon se kjo gjykatë nuk ka ndërmarr veprime procedurale në afat të arsyeshëm dhe se kjo mund të përbëjë shkelje të drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohorë, sikurse është garantuar me paragrafin 1. të nenit 6. KEDNJ, ku thuhet:

*“Çdokush, gjatë vendosjes mbi të drejtat dhe obligimet [...] ka të drejtë për seancë të drejtë dhe debat publik në afat të arsyeshëm kohorë [...]”*

24. Në shumë raste, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut (GJEDNJ) ka theksuar që pala ka të drejtë që lënda e tij të zgjidhet në afat të arsyeshëm kohorë, gjë që paraqet element kyç të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

25. Avokati i Popullit përkujton se praktika gjyqësore e GJEDNJ ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës llogaritet normalisht nga dita e inicimit të procedurës (shih aktgjykimin *Moldovan* dhe të tjerët kundër *Rumanisë* të datës 12. korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz* kundër *Poloni* të datës 30 shtator 2003). Deri në kohën kur është përfunduar lënda dhe/apo është ekzekutuar aktgjyimi (shih aktgjykimin *Poitier* kundër *Francës* të datës 8. nëntor, 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit përkujton se nen 6. i Konventës nuk parasheh kurrfarë afati përfundimtarë absolut për përcaktimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurës, por se vendimi i tij varet nga rrethanat e caktuara të rastit.

26. Avokati i Popullit thekson se GJEDNJ në rastin *Zimmermann* dhe *Steiner* kundër *Zvicrës*, ka thënë se një prej faktorëve të cilët duhet të merren parasysh është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore, dhe përgjegjësia e gjykatës që të organizojë punën e saj në mënyrë që individët të jenë të informuar në afat mbi rrjedhën e lëndëve të tyre në afatin e arsyeshëm. (Aktgjyki *Zimmermann* dhe *Steiner* kundër *Zvicrës* prej datës 13. korrik 1983).

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nen 22

27. Gjithashtu, Avokati i Popullit vëren se, “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes së procedurës sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ duhet të vlerësohet duke u thirrur në kriteret në vijim: kompleksiteti i lëndës, sjellja e parashtruesit të kërkesës dhe organeve kompetente, dhe me çfarë është rrezikuar ankuesi në lëndën e përmendur “(GJEDNJ [Doma e madhe], *Frydlender kundër Francës*, parashresa numër 30 979/ 6 (2000), paragrafi 43, duke u thirrur në GJEDNJ [Doma e madhe], *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, parashresa nr. 35382/97, paragrafi 19 (2000), paragrafi 19).
28. Avokati i Popullit vëren se lënda e ankuesit nuk ishte komplekse dhe ka të bëjë me aspekte procedurale të përmirësimit të emrit tek regjistrimi i të drejtave absolute në pronë dhe se sjellja e ankuesit nuk i ka kontribuar zvarritjes procedurale.
29. Përveç kësaj, Avokati i Popullit vëren se, lëndës është dashur t'i jepet prioritet gjatë veprimit për arsy se paditësi në procedurë tanë më ka 84 vite dhe është me gjendje të rëndë shëndetësore dhe zvarritja e mëtejshme e sjell paditësin në pasiguri të mëtejshme në zgjidhjen e çështjes pranë Gjykatës kompetente (dhe kjo në shkallën e parë), për çfarë gjykata është njoftuar disa herë sikur nga ana e ankuesit, ashtu edhe nga ana e Avokatit të Popullit. GJEDNJ, në aktgjykimin e datës 31 mars 1992 për rastin *X kundër Francës* (paragrafi 47) thekson se, ajo që në çështjen e procedurës kontestuese është e një rëndësie vendimtare për parashtruesin e parashtresës, duke pasur parasysh jetën e tij (në këtë rast të veçantë, është mosha e shtyrë e pleqërisë dhe gjendja e dobët shëndetësore) [...] dhe se ekziston rreziku që çfarëdo vonese mund të çojë deri në një situatë që çështja, të cilën po e zgjidh gjykata, mund të privohet nga synimi i saj. Në këtë rast, është kërkuar kujdes i jashtëzakonshëm, pavarësisht nga numri i rasteve që janë duke u proceduar. (shih X kundër Francës, § 47, Aktgjykimi i 31 marsit 1992).
30. Në vendimet e saj, GJEDNJ ka theksuar se organet gjyqësore duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme rasteve në të cilat interes i caktuar është i rëndësisë vitale për ankuesin (shih, psh, GJEDNJ, *Doustaly v. France*, lënda nr. 26256/95 (1998), paragrafi 48).
31. Sipas praktikës së GJEDNJ-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga data 29 dhjetor 2015, kur ankuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit
32. Prandaj, duke iu referuar Aktgjykimit të GJEDNJ (shih X kundër Francës, § 47, Aktgjykimi i datës 31 marsi 1992), si dhe duke pasur parasysh moshën e paditësit, ekziston rreziku që çfarëdo zvarritje procedurale (në rastin konkret gati tri vite) në gjykatë, i sjellë paditësit pasiguri të mëtejshme në zgjidhjen e çështjes në gjykatë.
33. Avokati i Popullit vëren se, pavarësisht ngarkesës së tepërt të gjykatësit përgjegjës përlëndën. Gjykata Themelore në Prishtinë është dashur të ndërmerr veprimet e caktuara në mënyrë që lëndët të cilat kërkojnë urgjencë në zgjidhje, sikurse është rasti me lëndën e ankuesit, të jenë përfunduar në afat të arsyeshëm kohor.

34. Madje edhe nëse marrim parasysh faktin që gjyqësori në përgjithësi ka problem me numrin e madh të lëndëve të grumbulluara, gjykatat kompetente ende kanë për obligim që të sigurojnë drejtësinë me kohë. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit gjithashtu rikujton se neni 10 i Ligjit për procedurën kontestimore thekson që gjykatat “do të zhvillojnë procedurën pa vonesa të panevojshme”.
35. Ankuesi ka parashtruar ankesë edhe në mungesën e mjetit efektiv juridik në kuptim të shkeljes së drejtës së tij në diskutim të drejtë në afat të arsyeshëm kohorë, gjë që është garantuar me nenin 6. KEDNJ, që përbën shkelje të drejtës së tij në mjet efektiv juridik sipas nenit 13. të Konventës, ku thuhet:
- “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përm bushje të funksioneve të tyre zyrtare”.*
36. Sa i përket zbatimit të nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GJEDNJ disa herë ka theksuar se vonesa e tepërt në ushtrimin e drejtësisë për sa kohë pala nuk ka kurrfarë mjeti juridik, përbën kërcënim për sundimin e ligjt brenda rendit të brendshëm juridik (shih psh. *Bottazzi kundër Italisë* aktgjykimi i datës 28. korrik 1999 dhe *Di Mauro kundër Italisë* aktgjykimi i datës 28. korrik 1999). Avokati i Popullit gjithashtu përkujton se edhe pse GJEDNJ ka konsideruar se kërkesat për mjet efektiv juridik duhet të interpretohen duke nënkuptuar se mjeti juridik mundet të jetë efektiv në pikëpamje të fushës së kufizuar të kërkesës së ndihmës të një konteksti të caktuar (*Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë* aktgjykimi i datës 6. shtator 1978), ajo konsideroi si në vijim:
- “Në pikëpamje të dështimit të theksuar që të sigurohet gjykim brenda afatit të arsyeshëm kohorë [...] asnje kualifikim i rëndësishëm në fushën e nenit 13. nuk mundet të dallohet. Në të kundërtën, pozita e nenit 13. në skemën e mbrojtjes së drejtave të njeriut të përcaktuara me Konventë do të diskutohej në favor të kufizimeve të theksuara të nenit 13. dhe do të i vonoheshin minimalist (*Kudla kundër Polonisë*, aktgjykimi i datës 26. tetor 2000. god.).*
37. Neni 13 reflektohet drejtpërdrejt në detyrimin e shteteve që së pari me sistemin e tyre ligjor të mbrojnë të drejtat e njeriut dhe në këtë mënyrë të krijojnë garanci shtesë individit, gjë që do të siguronte që ai apo ajo në mënyrë efektive të gëzojnë këto të drejta. Shikuar nga kjo perspektivë, e drejta e një personi në gjykim në afat të arsyeshëm do të jetë më pak efektive në rast se nuk ekziston asnjë mundësi që të parashtrohet ankesë tek autoritetet shtetërore. Dispozitat e nenit 13 forcojnë ato të nenit 6. (shih më herët është përmendur aktgjykimi i *Kudla*). Për këtë arsy, neni 13 garanton mjet efektiv juridik pranë autoriteteve shtetërore për shkelje të pretenduar të dispozitave nga neni 6 mbi përfundimin e çështjes në afat të arsyeshëm kohor. Meqenëse rasti ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i ndryshueshëm.
38. Sa i përket dispozitave të nenit 13 të KEDNJ-së, Avokati i Popullit përkujton që efekti i këtij neni është të kërkojë dispozitën e mjetit juridik për trajtimin e materies së “ankesës së kontestueshme” sipas Konventës, dhe të ndajë kompensim të përshtatshëm material (*Kaya kundër Turqisë*, Aktgjykimi i datës 19 shkurt 1998). Secili mjet i tillë juridik duhet

të jetë efektiv në praktikë dhe ligj (*Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykimi i datës 27. qershor 2000). Sa i përket ankesës në kohëzgjatjen e procedurës, Avokati i Popullit përkujton se “mjeti i efektshëm juridik” në pikëpamje të nenit 13. të Konventës do të duhej të jetë në gjendje të parandalojë shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e të njëjtë apo sigurimin e kompensimit adekuat për çfarëdo shkelje që ka ndodhur (shih më herët është përmendur aktgjykimi i *Kudla*).

39. Avokati i Popullit vëren se nuk ekziston kurrfarë qasje ligjore me të cilin ankuesi në lëndën në fjalë do të mundej të ankohet në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës me mundësi të realizimit të ndihmës preventive apo të kompensimit.
40. Prandaj, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të drejtës së ankuesit në mjetin efektiv juridik, të cilat garantohen me nenin 13 KEDNJ.


Në bazë të kësaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës “[...] ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetëror” dhe nenin 16 paragrafi 8 i Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përvëç rastit kur ka zvarritje të procedurave”, në bazë të analizës së lartpërmendur ligjore, në cilësinë e hartuesit të rekomandimeve, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemim gjyqësorë të Kosovës:

## REKOMANDON

### Gjykatën Themelore në Prishtinë

- Që pa zvarritje të mëtejshme të ndërmerr të gjitha veprimet relevante për shqyrtimin dhe vendosjen në lidhje me lëndën A.nr.2263/2015.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,  
  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit